

## **Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit shpall 2 (dy) vende pune për specialist IT.**

### **Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:**

1. Të ketë Diplomë të Nivelit të Dytë "Master i Shkencave" në Teknologji Informacioni, Informatikë, Inxhinieri Informatike.
2. Të ketë eksperiencë pune në fushën e Teknologjive të Informacionit, së paku 5 vite.
3. Të ketë përvojë në projekte të administrimit dhe sigurisë së sistemeve të Teknologjive të Informacionit, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare.
4. Të ketë njohuri të mira në njërën nga gjuhët e BE, preferohet Anglisht.
5. Të ketë cilësi të mira etike, komunikuese dhe aftësi të punojë në grup.
6. Të jetë i gatshëm të punojë me orare të zgjatura dhe në kushtet e emergjencave, sipas nevojave specifike që mund të lindin, për shkak të statusit të IGJEUM.

### **DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **01.04.2021** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.